




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01.Nr. 16-30567/15
Kaçanik, 29. 09. 2015

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040- Për Vetëqëverisjen Lokale(Gazeta Zyrtare Nr. 28 e datës 4 qershor 2008), lidhur me nenin 19 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233- Për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare Nr. 85 e dates 9 nentor 2010), si dhe Rekomandimit të Agjensionit për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë Nr.3644/15, të datës 14.07.2015, i cili vepron në kuadër të MMPH, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 29 shtator, 2015, mori këtë:

VENDIM

Për mbrojtjen e vlerës së natyrës të kompleksit të pishave në fshatin Strazhë si pejsazh i mbrojtur

1. Me këtë Vendim merret nën mbrojtje vlerat e natyrës - Kompleksi i pishave, në fshatin Strazhë - Komuna e Kaçanikut, si monument - pejsazh i natyrës të karakterit botanik.

1.1. Pejsazhi i mbrojtur ndodhet në fshatin Strazhë në sipërfaqe rreth 25 ha, pisha dekorative të mbjellura 25 vite më parë, koordinatat : **LAT:42.206053, LONG:21.205925**, dhe i cili paraqet një pejsazh mjaft tërheqës .

2. Pejsazhi i mbrojtur , sipas IUCN-it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së V - të. Natural Monument/ Natural Landmark –Monument i Natyrës

2.1. Për monumentin e natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III- të, mbrojtjes në të cilin përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

2.2. Në pejsazhin e mbrojtur ndalohet:

2.2.1. Prerja e trungjeve, thyerja (krasitja) e degëve, mbledhja e gjetheve,

2.2.2. Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur,

2.2.3. Mbjellja e bimëve të tjera në kompleksin e pishave,

2.2.4. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur ,

2.2.5. Ndryshimi i pamjes së sipërfaqes së mbrojtur,

2.2.6. Çdo lloj aktiviteti tjetër që i cili mundë të shkaktojë ndryshimin apo

dëmtimin e Pejsazhit të mbrojtur.

2.3. Në Pejsazhin e mbrojtur, lejohen:

2.3.1. Të gjitha masat mbrojtëse biologjike-teknike të nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të projektit për sanimin e gjendjes së monumentit të natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes së Pejsazhit.

3. Në zonën buferike të Pejsazhit të mbrojtur ndalohet:
 - 3.1. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi mbeturinave dhe mbetjeve tjera,
 - 3.2. Ndërrimi kulturës ,
 - 3.3. Ngjitja e objekteve të cilat kanë ndikim në pengimin e pamjes së Pejsazhit të mbrojtur.

4. Për zbatimin e masave mbrojtëse së Pejsazhit të mbrojtur , kujdeset Komuna e Kaçanikut.
 - 4.1. Komuna është e detyruar :
 - 4.1.1. Monumentin e natyrës ta mbrojë dhe ta mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtëse,
 - 4.1.2. Në rast të paraqitjes së ndryshimeve të cilat monumentin e natyrës mund ta shkatërrojnë ose ti dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tyre, menjëherë duhet ta lajmërojë Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,
 - 4.1.3. Të bëjë shënimin e kufinjëve të Pejsazhit të mbrojtur, në pajtim me Rregulloren për Shenjimin e Zonave të Mbrojtura.

5. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, baza ekonomike-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Pejsazhit të mbrojtur.

6. Ky Vendim pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikqyrës-MAPL-së, si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

7. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit,
3. Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike,
4. Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, dhe
5. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi